

PROGRAMI I PARTIS BALLIT KOMBETAR DEMOKRAT SHQIPETAR

1. NGRITJA E MIRQENJES EKONOMIKE NE NIVELIN KOMBETAR

Duke qenë të vetëdishëm për globalizimin e ekonomis në nivelin global ne mendojm se në ekonomin tonë duhet ti qasemi jo si shtetë por si komb duke e inkooperua ekonomin në nivelin kombëtar. Ne këtë mënyr arrim që ma shpejt të ngritim mirëqenjen ekonomike në nivelin kombëtar njëherit bëjm përafrimin e bashkimit kombëtar duke i gërshetuar këto të dyja bashkë.

2. SIGURIMI SHENDTSOR I QYTETARVE NE NIVELIN KOMBETAR

Ne do të formojm një fond të posaqëm ku do të grumbullohen mjetet që do ti dedikohen vetëm shëndetsis e që këto mjete do të mblidhen jo në nivel të shtetit të Republikës së Kosovës por në nivelin Kombëtar që edhe kjo mënyr do të kontriboj në përafrimin e bashkimit Kombëtar.

3. REFORMA NE SHERBIMIN PUBLIK

A. DREJTSA

Reforma në Drejtësi

B. SHENDETSIA

duke pas sigurimin shëndetsor për cdo qytetar ku secili do të paguaj për vizitat mjekësore do të krijohen kushte që të investohet në stafin mjekësor që mos të na ikin jashtë vendit ,dhe në teknollogji mjekësore

dhe në infrastruktur dhe shërbimet do të jenë më të mira qytetarët të jenë të kënaqur dhe krenar për shtetin e vetë, dhe largimi nga vendi do të zvoglohet dukshëm.

C. EDUKIMI

Sistemi i jonë i edukimit ka nëvoj për një reform të mirëfillët e që e kemi gjetur formulën se si të bëhet që kuadrat që dalin të jenë më të përgatitura për të kontribuar në profilet që i kanë zgjedhur.

4. RREGULLORJA SE SI TE TRAJTOHET QASJA E PAGAVE NE SEKTORIN PUBLIK DHE ATE PRIVAT

Në mendojm se paga nuk duhet trajtuar si pagë mujore e punëtorëve duke vënë në vlerë mujore por duhet trajtuar si vlerë për një orë punë duke vënë ligjin që sa është paga për një orë punë dhe se punëtorët e kanë obligim të punojnë në 8 orë në ditë dhe 40 orë në javë,

kështu punëdhënësve do tu cunohet e drejta për ta trajtuar punëtorin si skllav dhe do ti duhej të merr fuqi punëtore ma shumë dhe në këtë mënyrë do të ulët papunësia në vend ,kjo është mënyra e jonë se si do ti qasemi kësaj pike .

5,LUFTIMI I KORRUPCIONIT

Në dallim prej partive tjera që zotohen që do ta luftojn korrupcionin e që në realitet me rregulloret e punës për shërbimin publikë që i përcaktojnë krijojnë kushte për korrupcion e keqpërdorim e që janë në kahje të kundërt për ta luftuar korrupcionin ne mendojm se me ndrrimin e

rregullave të punes luftohet korrupcioni e jo me ndrrimin e personalitetit zyrtar që punojn në shërbimin publik .